

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Rehabilitimi dhe sistemimi i varrezave publike

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për varreza 45215400-1 Punime ndërtimi për rruge 45233120-6

VLERA E FONDIT LIMIT:

50,000,000 (pesëdhjetë milion) lekë pa tvsh

Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 2 (dy) muaj

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kavajë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;
- c. Sigurim oferte sipas Shtojcës 5;
- ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- d. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 11;
- e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 12;
- f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas Shtojcës 13;
- g. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas Shtojcës 14;
- gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhenenit _____

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2022, 2023 dhe 2024, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht,plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2 gërma "b", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Bazuar në nenin 43 pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" kjo kërkesa për konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Kërkesa për paraqitjen e xhiros së viteve financiare 2022, 2023 dhe 2024, nuk i kufizon operatorët ekonomik vetëm në vite që mund të jenë jo të sukseshme financiarish, por me kohështirje tre vjeçare. Vlera e xhiros së kërkuar në masë jo më e vogël se vlera e fondit limit shkon përshat me vlerën e fondit limit dhe afatin e realizimit të kontratës. Konkretisht niveli i aktivitetit të shoqërisë është në masë financiare ekuivalent me vlerën e mundshme të kontratës objekt prokurimi.

2.2.2Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2022, 2023 dhe 2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 43 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"

2.2.3.Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" nën 26 pika 6, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues i përcaktuar mësipër përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar nenit 26 pika 7, kanë për detyrë të japin sqarime dhe dokumente mbështetëse mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar, në cdo rast, me kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të provuar këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- i. Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin publik të paraqitet:
 1. formularin/formularët e vleresimit, të shoqëruar me aktin/aktet e kolaudimit dhe situacionet përkatëse, sipas shtojcës nr.9;
 2. faturat tatimore perkatese te deklaruar ne organet tatimore;
 3. kontratën/kontratat e zbatimit të punime të ndërtimit;
 4. çertifikatën/çertifikatat e marrjes në dorezim ose çertifikatën/çertifikatat e përkohshme të marrjes në dorëzim.

Në rast se kontratat e ngjashme janë lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqiten edhe kontratat e bashkëpunimit midis tyre.

Në rast se kontrata/kontratat e ngjashme janë lidhur në cilësinë e nënkontraktorit, operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin gjithashtu kontratën/kontratat bazë të lidhur me Autoritetin Kontraktor, në të cilën të jenë përfshirë dhe detyrimet e marra përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori.

- ii. Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin privat të paraqitet:
 1. kontrata/kontratat e sipërmarrjes së zbatimit të punime të ndërtimit;
 2. situacionet;
 3. faturat tatimore perkatese të deklaruar ne organet tatimore;
 4. akti/aktet e kolaudimit;
 5. çertifikatën/çertifikatat e marrjes në dorezim ose çertifikatën/çertifikatat e përkohshme të marrjes në dorëzim.

Në rast se kontratat e ngjashme janë lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqiten edhe kontratat e bashkëpunimit midis tyre.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve “a” ose “b” e bën ofertën të kualifikueshme

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, osejo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet referuar nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.2. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive dhe niveleve, si më poshtë:

1. NP 1 – A Punime gjurmimi në tokë
2. NP 2 – A Ndërtime civile dhe industriale.
3. NP 4 – B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
4. NP 7 – A Ujssjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.
5. NP 11 – A Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
6. NP 12 – A Punime të inxhinierisë mjedisore
7. NS 2 – A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
8. NS 4 – A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
9. NS 6 – A Sinjalistika rrugore jondriçuese.
10. NS 7 – A Barriera dhe mbrojtje rrugore.
11. NS 8 – A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.
12. NS 14 – A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
13. NS 18 – A Punime topogjeodezike.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

NP 1 - Punime gjurmimi në tokë. Në këtë projekt trajtohen gjurmimet në trupin e rrugës dhe kanaleet anësore, ndërtimi i mbushjes dhe gjurmimi për strukturat e Themeleve. Gjurmimet dhe mbushjet e nevojshme për krijimin e trupit të rrugës, kanaleve kulluese anësore, akseset, kalimet dhe pjerresite dhe të tjera si këto, si edhe për ndërtimin e strukturave, duhet të behen në format dhe dimensionet e treguara në vizatimet perkatese, vetëm në rastet e ndryshimeve të mundshme që Punëdhësi do të adoptojë, dhe të gjitha kostot që sjellin këto lloje punimesh do të jenë në ngarkim të Kontraktorit, duke përfshirë edhe ato për punimet mbrojtëse apo të perforcimeve të mundshme, të gjitha këto duhet të

jene llogaritur nga ai ne vendosjen e çmimit per njesi. Pjerresite e germimeve dhe dhe mbushje duhet te kryhen sipas pjerresise se pershtatshme sipas natyres dhe karakteristikave fiziko-mekanike te formacioneve

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara meçfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.

Konkretisht:

- Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet >
- Transport dheu me auto deri 5.0 km >
- Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet >
- Transport dheu me auto deri 5.0 km >
- Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet >
- Transport dheu me auto deri 5.0 km >
- Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet >
- Transport dheu me auto deri 5.0 km >
- Germim dheu me krah e transport k dore 10m, kat III >
- Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km >
- Germim dheu me krah e transport k dore 10m, kat III >

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, eshte me e vogel se 20 milion leke.

NP 2 - Ndërtime civile e industriale. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtëpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti mendonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

Konkretisht:

- Plinta e bazamente b/a monolite deri 20m³ C 16/20 >
- Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m >
- Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m >
- Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m >
- Plinta e bazamente b/a monolite deri 20m³ C 16/20 >
- Trare themeli b/a C 16/20 monolit >
- Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m >
- Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m >

- Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m >
- F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm >
- F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm >
- F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm >
- F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm >

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.

NP 4 - Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore

Konkretisht:

- Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri >
- Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, përhapur e ngjeshur me makineri >
- Shtrese stabilizant t=10cm >
- Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri >
- Shtrese stabilizant t=10cm >
- Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, përhapur e ngjeshur me makineri >
- Shtrese stabilizant t=10cm >
- Shtrese çakelli t=20cm, me cilindrim >
- Shtrese çakelli t=20cm, me cilindrim >
- Shtrese çakell me makineri t=20cm, me cilindrim >
- Shtrese me pllaka grez porcelanato >
- Shtrese çakelli t=20cm, me cilindrim >
- Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri >
- Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri >
- Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri >
- Shtrese betoni C 16/20 >
- Shtrese rere >
- Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri >
- Nenshtrese zhavori >
- Shtrese betoni C 6/10 >
- Shtrese betoni C 6/10 >

- Shtrese lluster çimento 1:2, t=30mm >
- Shtrese rere >
- Nenshtrese zhavori >
- Shtrese betoni C 6/10 >
- Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri >
- Shtrese lluster çimento 1:2, t=30mm >
- Struktura te holla monolite betoni C 16/20 >
- F.V. Bordura betoni 15x30cm >
- F.V. Bordura betoni 6x20 cm >
- F.V. Bordura betoni 12x25cm >
- Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka >

Niveli i klasifikimit është B. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e madhe se 21 milion leke dhe me e vogel se 50 milion leke.

NP 7 - Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pishëm, ujësjiellsat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Konkretisht:

- Tombino me tuba betoni Ø 1500, mbi shtrese betoni >
- Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni >
- Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize >
- Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm >

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogel se 20 milion leke.

N.P-11 Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloji tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore

Konkretisht:

- F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm >
- F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm >

- F.V. Ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004, me llampe 250W 230V >
- F.V. Elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm >
- F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm >
- F.V. Elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm >
- F.V. Percjellesa Cu te izoluar me gome, per ndricim, ne izolator, sexion 2.5mm² >
- F.V. Ne toke kablllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x10mm² >

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.

NP 12 - Punime të inxhinierisë mjedisore. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes ekulibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.

Punimet për ndërtimin e objektit kanë impakt mjedisor në të gjithë zonën përreth saj, duke patur parasysh sasinë e mbetjeve të gjeneruara nga punimet e prishjeve dhe germimeve. Bazuar në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" (i ndryshuar), si dhe nenin 39, pika 7, gërma "c", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" është e domosdoshme që shoqëritë të jenë të pajisura me licencat, certifikatat dhe stafin e specializuar për implementimin e kërkesave të akteve ligjore gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit.

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.

N.S –2Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre. Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithëshme.

Konkretisht:

- F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16 >
- F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16 >
- Termoizolim tubi Ø 1" me armofleks (d35x9) >
- F.V. Lavaman porcelani >
- F.V. WC allafrenga >
- F.V lavaman për PAK >
- F.V. WC allafrenga për PAK >
- F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d110 >
- F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d50 >
- F.Bryla RAU - PP d110 α = 45° >
- F Bryla RAU - PP d50 α = 45° >
- F.V Bryl 90° PP Ø 50 >

- F.V Brag 45° d110/110 >
- F.V Brag 45° d50/50 >
- F.V Brag 45° d110/50 >

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.

N.S-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese. Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Konkretisht:

- Mur me tulla me 6 vrima, t=12cm h~3m, ll perz M 15 >
- F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16 >
- Hidroizolim me nje shtres astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B >
- Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama >
- Veshje me pllake majolike >
- Plintuse grez h = 10 cm >
- Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe >
- Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25 >
- Suva e zakonshme fasade mur tulle mbi 8m lartesi >
- Boje hidroplastike >
- Boje hidroplastike cilesi e larte >
- F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e I-re. >
- Dyer d/alumini me mbushje element d/a. >
- F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham >
- Dyer d/alumini me mbushje element d/a. >

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.

N.S – 6 Sinjalistika rrugore jodriçuese. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.

Konkretisht:

- Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 cm. Bikomponente (paste) >
- Vizime me boje bikomponente >
- F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm >
- F.V. Tabela rrugore treguese 60x20cm >

- F.V. Fidane Peme dekorative >

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.

N.S – 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja rristurimi i elementeve si guard rail, new jersey, zvogëuesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa.

Konkretisht:

- F.V. Guardrail- H3 anesore me 3 valez. ne 1 ane, W5(elementi+lart) >

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.

N.S – 8 Ndërtim parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri. Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.

Konkretisht:

- F.V Konstrukione metalike te perbera >

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.

N.S- 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV. Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe rristurimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Konkretisht:

- F.V. Kasete plastike KE me 12 modular (vende) >
- F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A >
- F.V. Çelesa e priza 10 A me nulifikim >
- F.V. Priza shuko universal >
- F.V. Kuti suport pllaket 4 mod >
- F.V. Kuti suport pllaket 2 mod >
- F.V. Kutiderivacioni plastm >
- F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm >
- F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm² >
- F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=50mm² i zhveshur >
- F.V. Ndricues fluoreshent 2x40w,IP40 >
- F.V. Shirit tokezimi i galvanizuar St/Zn 40x4 ne kanale >

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.

NS 18 - Punime topogjeodezike. Konsiderohet zbatimi i rëlvimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Në këtë projekt përfshihen shumica e punimeve kërkojnë ekspertizën profesionale të topografisë. Nga fillimi i punimeve dhe deri në përfundim topografia ka rëndësi në këtë projekt, pasi ka sasi të konsiderueshme germimesh, rëlvime, sheshime etj.

Topogjeodezia së bashku me Sistemet e Informacionit Gjeografik janë baza e planifikimit të territorit. Organizimi i shërbimeve përkatesë për studiot e planifikimit urban, standartizimi i plotë i tyre në përputhje me kërkesat e planifikimit, bën të mundur krijimin e të dhënave gjeohapësinore, klasifikimin dhe interpretimin e tyre të saktë si dhe sjelljen në ndërtimin e skenarëve planifikues.

Referuar preventivit. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.

2.3.3. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune, diplomë, certificate/dëshmi kualifikimi të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial / ekuivalente, librezë pune, CV për 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier elektrik, 1 (një) inxhinier hidroteknik, 1 (një) inxhinier mekanik, 1 (një) inxhinier mjedisi dhe 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet/markshajder. Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik gjatë periudhës Shtator - Nëntor 2025 si dhe të figurojë në licensën e shoqërisë. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.
2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial/ekuivalente dhe të vlefshme për 1 (një) teknik ndërtimi, 6 (gjashtë) karpentier, 6 (gjashtë) betonues, 2 (dy) elektrikistë, 2 (dy) hidraulikë, 2 (dy) hidroizolues, 1 (një) bojaxhi, 4 (katër) muratorë, 1 (një) specialist për dyer e dritare, 5 (pesë) pllakashtrues, 2 (dy) hekurkthyes, 3 (tre) saldator. Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik të paktën gjatë periudhës Shtator - Nëntor 2025.
5. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe leje drejtimi përkatëse për 7 (shtatë) manovratorë/eskavatoristë dhe 4 (katër) shoferë.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” neni 26 pika 6, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues i përcaktuar mësipër përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar neni 26 pika 7, kanë për detyrë të japin sqarime dhe dokumente mbështetëse mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar, në çdo rast, me kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e punimeve.. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht gjithashtu edhe me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.2 të kriterëve teknike. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

- Inxhinieri i Ndërtimi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv. Gjithashtu kërkesa për inxhinier ndërtimi është në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP 3, NP 4, NS 1, NS 4
- Inxhinieri Elektrik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike/elektronike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv. Gjithashtu kërkesa për inxhinier elektrik është në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NS 14.
- Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv. Gjithashtu kërkesa për inxhinier hidroteknik është në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP 7, NS 2.
- Inxhinieri Mekanik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve në përcaktimin e materialeve më të mira për aplikime gjatë zbatimit të punimeve të parashikuara në projekt-preventiv. Një pjesë e kësaj është rezistenca e materialeve - testimi i ngarkesave mbështetëse, ngurtësisë, brishtësisë dhe vetive të tjera - të cilat janë thelbësore për shumë materiale ndërtimi dhe automobilistike. Gjithashtu kërkesa për inxhinier mekanik është në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NS7, NS 8.
- Inxhinier Mjedisi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve në lidhje me mjedisin te objektit lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv. Gjithashtu kërkesa për inxhinier mjedisi është në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP 12.
- Inxhinier Topograf/ Gjeodet/Markshajder është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve që përfshijn kuota dhe piktetime lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv. Në këtë projekt përfshihen shumica e punimeve kërkojnë ekspertizen profesionale të topografisë. Nga fillimi i punimeve dhe deri në përfundim topografia ka rëndësi në këtë projekt, pasi ka sasi të konsiderueshme germimesh, rievime, sheshime etj. Gjithashtu kërkesa për inxhinier mjedisi është në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NS 18.

Percaktimi i numrit te punonjesve dhe profesionet eshte bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve per perfundimin e punimeve, ne mbeshtetje te VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" dhe në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve dhe 1 (një) ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.“.

Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Eksperti që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve duhet te jete ne kantier per minizimin e aksidenteve ne pune.

Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave duhet te jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune, për të dhënë ndihmë e parë.

2.3.4. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 70 (shtatëdhjetë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, shoferë, manovratorë, stafi teknik) për periudhën Shtator - Nëntor 2025, i lëshuar nga Administrata Tatimore.
- Listëpagesat për periudhën Shtator -Nëntor 2025, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim", sic percaktohet ne tabelen bashkelidhur.

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
		1. PUNIME SHITESASH				
1	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri >	m2	300.00	0.010	3.00
2	3.21	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri >	m2	2950.00	0.210	619.50
3	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm >	m2	2950.00	0.080	236.00
4	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri >	m2	2160.00	0.010	21.60
5	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm >	m2	3100.00	0.080	248.00

6	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri >	m2	311.00	0.280	87.08
7	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm >	m2	311.00	0.080	24.88
Shuma 1:						1,240.06
2. PUNIME GERMIMI						
8	3.89/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet >	m3	3100.00	0.000	-
9	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km >	m3	3100.00	0.000	-
10	3.89/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet >	m3	150.00	0.000	-
11	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km >	m3	150.00	0.000	-
12	3.89/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet >	m3	10.00	0.000	-
13	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km >	m3	10.00	0.000	-
14	3.89/b	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet >	m3	93.00	0.000	-
15	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km >	m3	93.00	0.000	-
Shuma 2:						-
3. PUNIME DHEU						
16	2.1	Germim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III >	m3	80.00	3.700	296.00
17	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km >	m3	20.00	0.000	-
18	2.1	Germim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III >	m3	45.00	3.700	166.50
19	2.19	Hedhje,mbushje ngjeshje dheu të gërmuar,në kanal,tokë e butë (Hedhje humus për lulishtet) >	m3	31.00	1.250	38.75
Shuma 3:						501.25
4. NENSHTRESA DHE SHTRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE						
20	2.260/2	Shtrese çakelli t=20cm, me cilindrim >	m2	2950.00	0.350	1,032.50
21	2.260/2	Shtrese çakelli t=20cm, me cilindrim >	m2	753.00	0.350	263.55
22	2.26	Shtrese çakell me makineri t=20cm, me cilindrim >	m2	20.00	0.092	1.84
23	2.267/a	Shtrese me pllaka grez porcelanato >	m2	80.00	2.460	196.80
24	2.260/2	Shtrese çakelli t=20cm, me cilindrim >	m2	311.00	0.350	108.85
Shuma 4:						1,603.54
5. ANALIZA TEKNIKE						
25	3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri >	m2	2721.00	0.120	326.52
26	3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri >	m2	2160.00	0.120	259.20
Shuma 5:						585.72
6. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME						
27	3.369	Tombino me tuba betoni Ø 1500, mbi shtrese betoni >	m	10.00	15.900	159.00
28	3.367	Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni >	m	10.00	8.200	82.00
29	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve >	m3	150.00	0.040	6.00
30	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve >	m3	75.00	0.040	3.00
Shuma 6:						250.00
7. PUNIME SHTRESASH 2						
31	2.275	Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri >	m3	23.40	8.600	201.24
32	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20 >	m3	11.00	8.600	94.60
33	2.261	Shtrese rere >	m3	60.00	2.175	130.50
34	2.275	Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri >	m3	150.00	8.600	1,290.00
35	2.258	Nenshtrese zhavori >	m3	20.00	2.900	58.00
36	2.262	Shtrese betoni C 6/10 >	m3	1.50	8.600	12.90
37	2.262	Shtrese betoni C 6/10 >	m3	9.00	8.600	77.40
38	2.277	Shtrese lluster çimento 1:2, t=30mm >	m2	80.00	0.750	60.00

39	2.261	Shtrese rere >	m3	12.00	2.180	26.16
40	2.258	Nenshtrese zhavori >	m3	18.00	2.900	52.20
41	2.262	Shtrese betoni C 6/10 >	m3	1.50	8.600	12.90
42	2.275	Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri >	m3	61.00	8.600	524.60
43	2.277	Shtrese lluster çimento 1:2, t=30mm >	m2	311.00	0.750	233.25
Shuma 7:						2,773.75
		8. PUNIME BETONI E BETONARMEJE				
44	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20 >	m3	98.00	12.800	1,254.40
Shuma 8:						1,254.40
		9. PUNIME SHPYLLEZIMI				
45	3.1	Skarifikim bari me lopate >	m2	20,000.00	0.060	1,200.00
Shuma 9:						1,200.00
		10. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA				
46	3.903	F.V. Guardrail- H3 anesore me 3 valez. ne 1 ane, W5(elementi+lart) >	ml	25.00	2.280	57.00
47	3.164/1t	F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm >	ml	250.00	1.500	375.00
48	3.169	F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm >	copë	5.00	1.800	9.00
49	3.175	F.V. Ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004, me llampe 250W 230V >	copë	5.00	2.000	10.00
50	3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm >	copë	5.00	0.400	2.00
51	3.17	F.V. Pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm >	copë	5.00	3.800	19.00
52	3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm >	copë	3.00	0.400	1.20
Shuma 10:						473.20
		11. PUNIME TE NDRYSHME				
53	3.616/b	F.V. Bordura betoni 15x30cm >	m	260.00	1.000	260.00
54	3.619/a	F.V. Bordura betoni 6x20 cm >	m	64.00	0.530	33.92
55	3.616	F.V. Bordura betoni 12x25cm >	m	117.00	0.750	87.75
56	3.62	Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka >	m2	495.00	2.140	1,059.30
Shuma 11:						1,440.97
		12. B. SINJALET HORIZONTALE				
57	3.943/1	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 cm. Bikomponente (paste) >	ml	66.00	0.100	6.60
Shuma 12:						6.60
		13. D. SINJALET DHE PAJISJET SHITESH. NGADALESUESIT E SHPEJTESISË				
58	3.949	Vizime me boje bikomponente >	m2	35.00	0.500	17.50
59	3.955	F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm >	copë	1.00	0.500	0.50
60	3.954	F.V. Tabela rrugore treguese 60x20cm >	copë	1.00	0.300	0.30
61	3.961	F.V. Fidane Peme dekorative >	copë	16.00	1.000	16.00
Shuma 13:						34.30
		14. UJESJELLES E KANALIZIM I JASHEM				
62	2.342	Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize >	copë	7.00	5.600	39.20
63	2.336	Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm >	copë	2.00	6.800	13.60
Shuma 14:						52.80
		15. GAZ E NAFTESJELLES				
64	4.150/3	F.V. Percjellesa Cu te izoluar me gome, per ndricim, ne izolator, sexion 2.5mm2 >	km	0.53	100.000	52.50
65	4.133/3.5	F.V. Ne toke kablo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulesa plastmasi, te armuar, 4x10mm2 >	m	150.00	0.450	67.50
Shuma 15:						120.00
		16. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE				
66	2.491/c	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16 >	ml	550.00	0.300	165.00
67	2.491/c	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16 >	ml	2.00	0.300	0.60

68	2.535/c	Termoizolim tubi Ø 1" me armofleks (d35x9) >	ml	4.00	0.100	0.40
69	2.495	F.V. Lavaman porcelani >	copë	2.00	2.950	5.90
70	2.501	F.V. WC allafrenga >	copë	4.00	3.700	14.80
Shuma 16:						186.70
		17. ANALIZA TEKNIKE PER PUNIMET DHE INSTALIMET TEKNOLOGJIKE				
71	4.1	F.V Konstruksione metalike te perbera >	ton	23.45	45.000	1,055.25
		Shuma 17:				1,055.25
		18. PUNIME BETONI DHE B/A				
72	2.114	Plinta e bazamente b/a monolite deri 20m3 C 16/20 >	m3	27.00	6.930	187.11
73	2.117/1b	Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m >	m3	7.20	31.220	224.78
74	2.119/1a	Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m >	m3	10.70	20.600	220.42
75	2.125/1a	Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m >	m2	88.00	2.400	211.20
76	2.114	Plinta e bazamente b/a monolite deri 20m3 C 16/20 >	m3	12.00	6.930	83.16
77	2.116	Trare themeli b/a C 16/20 monolit >	m3	14.00	15.330	214.62
78	2.117/1b	Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m >	m3	6.80	31.220	212.30
79	2.119/1a	Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m >	m3	7.00	20.600	144.20
80	2.125/1a	Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m >	m2	30.00	2.400	72.00
Shuma 18:						1,569.79
		19. PUNIME HEKUR BETONI				
81	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm >	ton	3.20	60.000	192.00
82	2.166/1a	F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm >	ton	6.20	42.000	260.40
83	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm >	ton	1.00	60.000	60.00
84	2.166/1a	F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm >	ton	3.80	42.000	159.60
Shuma 19:						672.00
		20. PUNIME MURATURE TULLE				
85	2.86.	Mur me tulla me 6 vrima, t=12cm h~3m, ll perz M 15 >	m3	33.00	14.000	462.00
Shuma 20:						462.00
		21. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE				
86	2.196/b	Hidroizolim me nje shtres astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B >	m2	150.00	0.420	63.00
87	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama >	m2	120.00	1.000	120.00
88	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 >	ml	8.00	1.090	8.72
89	2.206	Kasete shkarkimi me llamarine xingat >	copë	2.00	2.420	4.84
90	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm >	ml	10.00	1.300	13.00
91	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 >	ml	5.00	1.090	5.45
Shuma 21:						215.01
		22. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI				
92	2.326	Veshje me pllake majolike >	m2	80.00	3.700	296.00
93	2.324b	Plintuse grez h = 10 cm >	ml	40.00	0.350	14.00
94	2.300/1	Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe >	m2	80.00	1.425	114.00
95	2.310/1	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25 >	m2	220.00	0.775	170.50
96	2.334	Suva e zakonshme fasade mur tulle mbi 8m lartesi >	m2	160.00	2.500	400.00
Shuma 22:						994.50
		23. PUNIME BOJATISJE				
97	2.404	Boje hidroplastike >	m2	300.00	0.360	108.00
98	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte >	m2	160.00	0.360	57.60
Shuma 23:						165.60

		24. PUNIME DYER DRITARE				
99	2.383/1	F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e I-re. >	m2	12.00	0.660	7.92
100	2.395/a	Dyer d/alumini me mbushje element d/a. >	m2	6.50	2.400	15.60
101	2.375/1	F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham >	m2	11.00	2.650	29.15
102	2.395/a	Dyer d/alumini me mbushje element d/a. >	m2	8.00	2.400	19.20
Shuma 24:						71.87
		25. INSTALIME PER NDRICIM				
103	2.490/d	F.V. Kasete plastike KE me 12 modular (vende) >	copë	1.00	2.500	2.50
104	2.490/1c	F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A >	copë	1.00	1.300	1.30
105	2.485	F.V. Çelesa e priza 10 A me nulifikim >	copë	8.00	1.000	8.00
106	2.485/d	F.V. Priza shuko universal >	copë	8.00	1.000	8.00
107	2.487/b	F.V. Kuti suport pllaket 4 mod >	copë	8.00	0.250	2.00
108	2.487/a	F.V. Kuti suport pllaket 2 mod >	copë	8.00	0.250	2.00
109	2.487	F.V. Kutiderivacioni plastm >	copë	3.00	0.330	0.99
110	2.480/2	F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm >	ml	50.00	0.320	16.00
111	2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2 >	ml	150.00	0.040	6.00
112	2.502	F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=50mm2 i zhveshur >	m	30.00	0.050	1.50
113	2.472	F.V. Ndricues fluoreshent 2x40w,IP40 >	copë	10.00	1.500	15.00
Shuma 25:						63.29
		26. ANALIZA TEKNIKE TE REJA 4				
114	4.37	F.V. Shirit tokezimi i galvanizuar St/Zn 40x4 ne kanale >	ml	10.00	0.100	1.00
Shuma 26:						1.00
		27. ANALIZA JASHTE LISTE				
115	An	Shpim Mikrotunel Komplet+Aksesore d=400mm >	ml	85.00	0.700	59.50
116	An	FV Cezem >	copë	7.00	2.000	14.00
117	An	F.V. Stol me krahë gize, 150x60x75 cm >	copë	10.00	1.000	10.00
118	An	F.V lavaman per PAK >	copë	1.00	2.900	2.95
119	An	F.V. WC allafrenga per PAK >	copë	1.00	3.700	3.70
120	An	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d110 >	ml	25.00	0.300	7.50
121	An	F.V Tubo shkarkimi RAU - PP d50 >	ml	30.00	0.300	9.00
122	An	F.Bryla RAU - PP d110 $\alpha = 45^\circ$ >	copë	15.00	0.500	7.50
123	An	F Bryla RAU - PP d50 $\alpha = 45^\circ$ >	copë	35.00	0.500	17.50
124	An	F.V Bryl 90° PP Ø 50 >	copë	10.00	0.500	5.00
125	An	F.V Brag 45° d110/110 >	copë	3.00	0.500	1.50
126	An	F.V Brag 45° d50/50 >	copë	2.00	0.500	1.00
127	An	F.V Brag 45° d110/50 >	copë	10.00	0.500	5.00
128	An	F.V Tubo PEHD I magjistralit I rrudhosur Ø 160 mm >	ml	30.23	0.500	15.12
129	An	F.V Tubo PEHD I magjistralit I rrudhosur Ø 200 mm >	ml	35.00	0.500	17.50
130	An	Stol betoni per aktivitet fetar >	copë	1.00	2.000	2.00
131	An	Shtrimi me pllake troktolit 5 cm >	m2	311.00	3.120	970.32
132	An	Evadim, trajtim dhe asgjesisim i mbetjeve te rrezikshme (eternit etj) >	m2	81.00	0.500	40.50
Shuma 27:						1,189.59
Orë pune gjithsej						18,546.85
Numër punëtorësh Total = Orë pune gjithsej : 8 orë pune në ditë : 44 dite (8 javë)						53

2.3.5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë

3 (tre) kamionë me kapacitet mbajtës ≥ 18 ton;
2 (dy) kamionë me kapacitet mbajtës 10 - 18 ton;
3 (tre) kamionë/kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton;
1 (një) makinë skarifikimi,
1 (një) autobot uji,
4 (katër) rul me vibrim,
1 (një) grejder,
2 (dy) eskavator me goma 0.25m³,
1 (një) autobitumatrice,
1 (një) asfaltoshtruese,
1 (një) vinc kullë 6-10T (shoqeruar me skede teknike),
1 (një) autovinc ± 2.5 ton,
1 (një) fadromë,
1 (një) makineri për montim guard rail,
1 (një) makinë vijëzimi,
1 (një) autobetoniere,
1 (një) autopompe betoni,
2 (dy) vibrator thellësie,
1 (një) pompë suvatimi,
1 (një) gazogjen,
2 (dy) elektrosaldatriçe,
1 (një) elektroorgano,
200 (dyqind) m² skelë inventar
1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë;
4(kater) depozita uji 1000 literoshe,
1(një) sonde per shpim dheu DN 350-400,
1(një) sistem drenazhimi well point
1(një) paisje gjeodezike Total Station.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë leje e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto perkatëse ballore dhe anesore.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë kontratë noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të jenë leja e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto perkatëse ballore dhe anesore..

Për mjetet dhe pajisjet që nuk pajisen me leje qarkullimi operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë dokument te vlefshëm që vërteton pronësinë apo marrjen me qira të tij dhe foto perkatëse.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” neni 26 pika 6, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues i përcaktuar mesipër përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. Referuar nenit 26 pika 7, kanë për detyrë të japin sqarime dhe

dokumente mbështetëse mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar, në cdo rast, me kërkesë të Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 *"Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"*.

Konkretisht:

- 3 (tre) kamionë me kapacitet mbajtës ≥ 18 ton; 2 (dy) kamionë me kapacitet mbajtës 10 - 18 ton; 3 (tre) kamionë/kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton; pothuajse mbulojnë të gjithë zërat e punimeve në preventiv.
- 1 (një) makinë skarifikimi, parashikuar në zërat e punimeve në preventiv Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri >.
- 1 (një) autobot uji, parashikuar në zërat e punimeve në preventiv Shtrese stabilizant t=10cm >;
- 4 (katër) rul me vibrim, parashikuar në zërat e punimeve në preventiv Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, përhapur e ngjeshur me makineri >; Shtrese stabilizant t=10cm >; Shtrese stabilizant t=10cm >; Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, përhapur e ngjeshur me makineri >; Shtrese stabilizant t=10cm >; Shtrese çakelli t=20cm, me cilindrim >; Shtrese çakelli t=20cm, me cilindrim >; Shtrese çakell me makineri t=20cm, me cilindrim >; Shtrese çakelli t=20cm, me cilindrim >; Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri >; Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri >.
- 1 (një) grejder, parashikuar në zërat e punimeve në preventiv Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, përhapur e ngjeshur me makineri >; Shtrese stabilizant t=10cm >; Shtrese stabilizant t=10cm >; Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, përhapur e ngjeshur me makineri >; Shtrese stabilizant t=10cm >; Shtrese çakelli t=20cm, me cilindrim >; Shtrese çakelli t=20cm, me cilindrim >; Shtrese çakell me makineri t=20cm, me cilindrim >; Shtrese çakelli t=20cm, me cilindrim >.
- 2 (dy) eskavator me goma 0.25m³,parashikuar në zërat e punimeve në preventiv Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet >; ne total germim dheu mbi 3,000 m³.
- 1 (një) autobitumatrice, parashikuar në zërat e punimeve në preventiv Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri >.
- 1 (një) asfaltoshtuese,parashikuar në zërat e punimeve në preventiv Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri >.
- 1 (një) vinc kullë 6-10T (shoqeruar me skede teknike),parashikuar në zërat e punimeve në preventiv Shtrese me pllaka grez porcelanato >; Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri >; Shtrese betoni C 16/20 >; Shtrese betoni C 6/10 >; Shtrese lluster çimento 1:2, t=30mm >; F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm >; F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm >; Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25 >; Suva e zakonshme fasade mur tulle mbi 8m lartesi >.
- 1 (një) autovinc ±2.5 ton,parashikuar në zërat e punimeve në preventiv F.V. Ndricues Smart VP CL1 CR M-S 250W GG FAE 44004, me llampe 250W 230V >

- 1 (një) fadromë,parashikuar në zërat e punimeve në preventiv Mbushje me zhavorr pas mureve >.
- 1 (një) makineri për montim guard rail,parashikuar në zërat e punimeve në preventiv F.V. Guardrail- H3 anesore me 3 valez. ne 1 ane, W5(elementi+lart) >
- 1 (një) makinë vijëzimi,parashikuar në zërat e punimeve në preventiv Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 cm. Bikomponente (paste) >; Vizime me boje bikomponente >.
- 1 (një) autobetoniere, parashikuar në zërat e punimeve në preventiv Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri >; Shtrese betoni C 16/20 >; Shtrese betoni C 6/10 >; Plinta e bazamente b/a monolite deri 20m3 C 16/20 >; Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m >; Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m >; Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m > etj.
- 1 (një) autopompe betoni,parashikuar në zërat e punimeve në preventivShtrese betoni C16/20 me zgare hekuri >; Shtrese betoni C 16/20 >; Shtrese betoni C 6/10 >; Plinta e bazamente b/a monolite deri 20m3 C 16/20 >; Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m >; Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m >; Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m > etj.
- 2 (dy) vibrator thellësie,parashikuar në zërat e punimeve në preventivShtrese betoni C16/20 me zgare hekuri >; Shtrese betoni C 16/20 >; Shtrese betoni C 6/10 >; Plinta e bazamente b/a monolite deri 20m3 C 16/20 >; Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m >; Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m >; Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t=30cm, h~6m > etj.
- 1 (një) pompë suvatimi,parashikuar në zërat e punimeve në preventivSuva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe >; Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25 >.
- 1 (një) gazogjen,parashikuar në zërat e punimeve në preventivF.V Konstruksione metalike te perbera >.
- 2 (dy) elektrosaldatriçe,parashikuar në zërat e punimeve në preventivF.V Konstruksione metalike te perbera >
- 1 (një) elektroorgano,parashikuar në zërat e punimeve në preventivHidroizolim me nje shtres astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B >; Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama >.
- 200 (dyqind) m2 skelë inventarparashikuar në zërat e punimeve në preventiv Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m >; Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m >; Mur me tulla me 6 vrima, t=12cm h~3m, ll perz M 15 >; Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe >; Suva e zakonshme fasade mur tulle mbi 8m lartesi >
- 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë; për lëvizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë.
- 4(kater) depozita uji 1000 literoshe,
- 1(nje) sonde per shpim dheu DN 350-400; Shpim Mikrotunel Komplet+Aksesore d=400mm >
- 1(nje) sistem drenazhimi well point
- 1(nje) paisje gjeodezike Total Station

2.3.6. Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalente.

2. Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015** ”Sisteme të menaxhimit të mjedisit” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalente.
3. Certifikatën SSH/ EN/UNI **ISO 45001:2018/45001-2023** ”Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalent.
4. Certifikatën SSH EN **ISO 3834-5:2021** “Kërkesat e cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalente.
5. Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 50001-2018**, ”Sistemi i Menaxhimit të Energjisë” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalent.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim opera torësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/DIN/EN/UNI mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,* si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis të projektit si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 3834-5:2021 është standart ndërkombëtar, i cili specifikon kërkesat e cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike. Kërkesa për këtë standard lidhet ngushtë me implementimin e zërave të preventivit, konkretisht të atyre zërave që kanë të bëjnë me konstruksione metalike.

ISO 50001-2018 është standart ndërkombëtar, i cili specifikon kërkesat e përgjithshme për krijimin e një Sistemi të Menaxhimit të Energjisë në një organizatë dhe fokusohet në identifikimin e mundësive për përmirësimin e performancës së energjisë. ISO 50001 përcakton synimet dhe objektivat specifike për kursimin e energjisë, të cilat arrihen përmes programeve për menaxhimin e energjisë dhe monitorimin sistematik të variablave të energjisë.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat e parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.10 germa “a”- “e”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.7. Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore kodi III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në ligjin Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (Ndryshuar me ligjin nr. 32/2013, datë 14.2.2013; nr. 156/2013, datë 10.10.2013; nr. 28/2022, datë 17.3.2022).

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të ketë Kontrate Shërbimi me një laborator testimi të materialeve kryesore të ndertimit i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-4:2019, SSH EN 12350-4:2019 dhe SSH EN 12504-4:2021 e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet ti paraqesë të pakten njëri nga anëtarët e grupit

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 8 të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me anë të këtij kriteri AK kërkon që produktet të jenë në përputhje me standartet e duhura përpara se ato të perdoren, ky është detyrim ligjor kontraktor.

Operatorët ekonomikë, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.